

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Natural Water"SH.P.K.**

Sot më datë 02.04.2021, palët e mëposhtme:

Eduart Masha, i biri i Destanit, shtetas shqiptar, lindur më 31.10.1975 në Tiranë dhe banues në Rr. Herman Gmainer, Nd. 10, H1, Njesia administrative nr. 2, Sauk, Tiranë, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me numër personal H510311090, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar;

I cili, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka vendosur të krijojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Natural Water Sh.p.k. (në vijim referuar dhe si "Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur Natural Water Shpk. Gjithashtu dhe emri tregtar i shoqërisë do të jetë Natural Water Shpk.

Neni 2 – Selia

Selia e Shoqërisë është në: Njesia Administrative Nr. 5, Rruga Prokop Mima, Pall. Pajtoni, Kati 2, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është për me një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë: tregti i ujeve natyrale me shumicë dhe pakicë, shfrytëzim i burimeve natyrore të ujit, përpunim dhe ambalazhim i ujit, etj.

Aktiviteti i sipërpërmendur do të realizohet duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga ortakët e vetëm të saj.

Shoqëria mund të zgjerohet ose kufizohet në fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

Neni 5 – Kapitali

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.

5.2 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar tërësisht si mëposhtë:

- a) Eduart Masha, ka kontribuar në kapitalin e Shoqërisë një shumë të barabartë me 100 LEK e cila tashmë është paguar.

5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara:

- (a) Eduart Masha zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (njëqindpërqind) të kapitalit themelues të shoqërisë ("Ortakët e Vetëm").

Neni 6 - **Transferimi i PjesëvetëKapitalit**

Pjeset e kapitalit të Shoqërsë mund të transferohen tërësisht apo pjesërisht sipas procedurave tëparashikuara në Nenin 9 tëStatutit.

Neni 7 –**Administratorët**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga 1 Administrator ("Administratori"), i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht një ortak dhe do të emërohet për një kohëzgjatje 5 vjeçare nga Ortaku i Vetëm. Në fund të afatit 5 vjeçar, përveç nëse Ortaku i Vetëm ka vendosur për shkarkimin e Administratorit para skadimit të mandatit të tij, Administratori mund të riemërohet ose të shkarkohet.
- 7.2 Administratori përfaqeson Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.
- 7.3 Me këtë akt, personi i mëposhtëm emërohet Administrator i vetëm i Shoqërisë për një periudhë 5-vjeçare:
- Z. Eduart Masha, shtetas shqiptar, i biri i Destanit, i lindur në Tiranë, më 31/10/1975 ,banues ne Rr. Herman Gmainer, Nd. 10, H1, Njesia administrative nr. 2, Sauk, Tiranë, mbajtës i leternjoftimit me numer personal H510311090
- 7.4 Kompetencat e Administratorit do të kryhen në përputhje me Nenin 13 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 8 -**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 8.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me këtë Akt Themelimi apo për mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të treta do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 8.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9–**Gjuha**

Ky Akt Themelimi është hartuar me vullnetin e lire dhe të plotë të Ortakut të Vetëm, redaktohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtte juridike.


Neni 10 - **DispozitatëFundit**

Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Shoqërisë dhe legjisllacionit për Shoqëritë Tregtare.

Natural Water Shpk

Ortaku i Vetëm
Eduart Masha

EDUART MASHA

 2

